



BASHKIA  
TIRANË  
REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 101 datë 28.09.2020

**“PËR  
MIRATIMIN E FAMILJEVE APLIKUESE QË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I  
BLOK-NDIHMËS EKONOMIKE DERI NË 6 PËR QIND, NGA FONDI I  
KUSHTËZUAR DHE NGA BUXHETI I BASHKISË TIRANË, PËR PERIUdhËN 1-31  
GUSHT 2020”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat “a” dhe “b”, nenit 24, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, Kreut IV, pikat 2, 3 dhe 6, të vendimit nr. 597, datë 04.09.2019, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, vendimit nr. 157, datë 26.12.2019, të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2020-2022 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2020”, të ndryshuar, vendimit nr. 3, datë 05.02.2020, të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e kriterëve, procedurave, dokumentacionit dhe sistemit të pikëzimit, për përdorimin e fondit të kushtëzuar ose fondit të buxhetit vendor, mbi programin e bllok-ndihmës ekonomike deri në 6 për qind për vitin 2020”, si dhe referuar Raportit Përmbledhës nr. 31161 prot., datë 17.08.2020, me propozimin e kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I :**

1. Miratimin e listës së familjeve përfituese nga programi i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6 për qind nga buxheti i Bashkisë Tiranë, për periudhën 1-31 Gusht 2020, sipas tabelës nr.1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Miratimin e listës së familjeve përfituese nga programi i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6 për qind nga fondi i kushtëzuar për periudhën 1-31 Gusht 2020, sipas tabelës nr. 2, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Efektet financiare sipas pikave 1 dhe 2, të këtij vendimi, do të mbulohen nga fondi i vënë në dispozicion nga fondi i kushtëzuar dhe buxheti vendor për programin e bllok-ndihmës ekonomike deri në 6 për qind.
4. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale dhe Njësitë Administrative të Bashkisë Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

**K R Y E T A R I**

**TONI GOGU**